

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 37 paragrafit 6 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18, 178/'21, 58/'24); nenit 163 dhe nenit 349 paragrafit 6 të Statutit të Universitetit të Tetovës; nenit 55 dhe nenit 106 paragrafit 6 të Statutit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, dekani i Fakultetit, më datë 12.06.2025, solli këtë:

VENDIM

për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit në Universitetin e Tetovës

Neni 1

(1) Shpallen zgjedhje për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit - Universiteti i Tetovës.

Neni 2

- (1) Anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të ndershme dhe demokratike me votim të fshehtë.
- (2) Kryetari i Kuvendit Studentor të Fakultetit, zgjidhet në mbledhjen e parë konstituive të Kuvendit studentor, nga radhët e anëtarëve të zgjedhur, në përputhje me Statutin e Kuvendit studentor të Fakultetit.

Neni 3

- (1) Zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit, do të mbahen me votim të fshehtë më datë 14.07.2025 (e Hënë), në sallën e Fakultetit nr. 30, me fillim nga ora 08:30 deri në orën 16:30.

Neni 4

Emërohet Komision Zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit, në këtë përbërje:

- 1) Prof. Dr. Xhezair Idrizi mësimdhënës në Fakultet – kryetar,
- 2) Mr. Sc. Durim Alija asistent në Fakultet – anëtar,
- 3) Arta Hismani studente në semestrin e IV viti i II i studimeve në programin studimor “Nutricion” në vitin akademik 2024/2025, me numër indeksi: 230235 anëtare,
- 4) Dea Osmani studente në semestrin e IV viti i II i studimeve në programin studimor “Nurricion” në vitin akademik 2024/2025, me numër indeksi: 230836 anëtar,
- 5) Tarik Kuçllar student në semestrin e II viti i I i studimeve në programin studimor “Teknologji Ushqimore” në vitin akademik 2024/2025, me numër indeksi: 420365 anëtar.

Neni 5

- (1) Komisioni Zgjedhor nga neni 4 i këtij Vendimi:

- përcakton rregullat dhe miraton Udhëzuesin për procedurën e zhvillimit të zgjedhjeve;
- përcakton listën e kandidatëve të propozuar, bazuar në verifikimin paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u propozuar si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit (nëse janë studentë aktivë, pra, të regjistruar në semestrin/vitin në të cilin mbahen zgjedhjet);
- e përcakton pamjen e fletës së votimit/formularëve të procesverbaleve, si dhe dokumentacionin tjetër që del nga rrjedha e procedurës për zhvillimin e zgjedhjeve;

- e përcakton mënyrën e votimit, numërimin e votave, dhe veprimin ndaj ankesave brenda një afati prej 24 orëve nga momenti i paraqitjes së tyre;
- kryen edhe detyra të tjera që lidhen me rrjedhën e zhvillimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit.

(2) Udhëzuesi i Komisionit Zgjedhor publikohet në tabelën e shpalljeve/faqen zyrtare të Fakultetit, jo më vonë se 7 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, së bashku me Vendimin për listën e përcaktuar të kandidatëve studentë që i plotësojnë kushtet (lista përfundimtare).

Neni 6

- (1) Kuvendi Studentor i Fakultetit përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues nga secili program studimor të njësive të Universitetit,
- (2) Në rast se nuk plotësohet numri i anëtarëve për secilin program studimor, në përputhje me paragrafin e mëparshëm, për shkak të mungesës së studentëve që i plotësojnë kushtet, vendet e paplotësuara nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit, pra ai do të përbëhet nga aq anëtarë sa ka studentë që i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur dhe që do të jenë të zgjedhur.

Neni 7

- (1) Të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit kanë të gjithë studentët e Fakultetit, të cilët janë të regjistruar në studime gjatë vitit akademik në të cilin zgjidhet Kuvendi Studentor i Fakultetit.
- (2) Kryetar i Kuvendit Studentor i Fakultetit, mund të zgjidhet student i rregullt i cili ka të regjistruar semestrin veror të vitit akademik 2024/25, me notë mesatare së paku 8.00 (tetë).

Neni 8

- (1) Anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Studentor të Fakultetit konsiderohen ata kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave nga studentët e Fakultetit që kanë votuar.

Neni 9

- (1) Komisioni Zgjedhor obligohet që t'i zhvillojë zgjedhjet në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit dhe Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit.

Neni 10

- (1) Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij dhe publikohet në tabelën e shpalljeve/faqen zyrtare të Fakultetit.

Tetovë, 12.06.2025



Dekan
Prof. Dr. Gafur Xhabiri